



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Publikimi (shpallja) e organizimit të edukimit në institucionet parashkollore

NUMËR: 45 /2007

DATË : 9.10.2007

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, nenit 11.3 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është publikimi (shpallja) i/e çështjeve më të rëndësishme që kanë të bëjnë me organizimin e edukimit në institucionin parashkollor.

Neni 2

Informacionet

Institucioni parashkollor është i obliguar që para pranimit të fëmijëve, t'u ofrojë prindërve informacione të mjaftueshme për:

- a) emërtimin e programit,
- b) planprogramet e punës edukuese dhe arsimore,
- c) përmbajtjet dhe metodat e punës,
- d) premisat filozofike,

- e) kohëzgjatjen e programeve,
- f) mënyrën dhe format e bashkëpunimit me prindër,
- g) fushat dhe objektivat e veprimtarisë edukuese e arsimore,
- h) opinionin e Këshillit të ekspertëve të programeve dhe teksteve shkollore të MASHT-it.

Neni 3

Publikimi

Institucioni parashkollor është i obliguar që të bëjë publike të gjitha pikat e nenit 2 të këtij Udhëzimi administrativ përmes: kontaktit me prindër, shpalljeve tabelare në institucion dhe sipas nevojës edhe në shpallje publike, gazeta ditore, fletushka të institucionit përkatës, televizionit dhe radios.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga ministri.

Agim Veliu, ministër